

Moneta është institucion financiar jo-bankar, i specializuar në ofrimin e shërbimeve financiare, me një personel me përvojë shumëvjeçare në këtë fushë. Me qëllim të avancimit të veprimtarisë, Moneta tani është duke kërkuar kandidat të kualifikuar dhe profesional, për pozitën:

## Zyrtar/e i/e Financave dhe Kontabilitetit

### Detyrat e punës dhe përgjegjësitë:

- Regjistrimi kontabël i dokumentacionit të pranuar në softuerin e kontabilitetit si dhe rikonsilimet e llogarive bankare në baza ditore;
- Kontrollimi i regjistrimit të transaksioneve;
- Përgatitja e regjistrit të detyrimeve për pagesë me detajet e kreditorëve dhe përcjellja e kryerjes me kohë të të gjitha detyrimeve në baza ditore;
- Barazimi i llogarive të agjentëve në baza ditore;
- Barazimi i llogarive të pagueshme dhe llogarive të arkëtueshme me partnerët afarist në periudha të caktuara kohore;
- Mirembajtja e listës së aseteve fikse;
- Regjistrimet rregulluese në fund të muajit, duke marr parasysh edhe buxhetimin;
- Siguron që në çdo kohë informatat të cilat janë në sistemin e kontabilitetit janë të paraqitura në formë të drejtë dhe të saktë;
- Siguron autorizimet për shpenzimet e linjave buxhetore;
- Përpilon planin e Biznesit të Korporatës si dhe përcjell në mënyrë të vazhdueshme shpenzimet e vijave buxhetore;
- Përgatitja e Pakos raportuese për Menaxhmentin e Korporatës përfshirë raportin financiar dhe menaxherial në baza mujore dhe varësisht prej kërkesës;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe kuartale për raportim në BQK;
- Deklarimi i pagave dhe librit të TVSH-se në baza mujore;
- Përgatitje të pasqyrave finance vjetore për deklarim në ATK;
- Kryen dhe detyra të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit direkt.

### Kualifikimet dhe shkathtësitë profesionale:

- Diplomë universitare në ekonomi apo në fusha të ngjashme;
- Preferohet të ketë çertifikatë nga SCAAK në nivelin e teknikut apo kontabilistit;
- Preferohet të ketë njohuri të sistemit Quickbooks;
- Njohuri të mira të pakos së MS Office (veçanërisht Excel);
- Shkathtësi të shkëlqyera numerike dhe analitike;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi në gjuhën shqipe dhe angleze;

Të gjithë të interesuarit duhet të aplikojnë përmes sistemit elektronik të rekrutimit në [www.monetaks.com](http://www.monetaks.com) apo të dërgoni email në [hr@monetaks.com](mailto:hr@monetaks.com). Së bashku me Aplikacionin apo email-in, ju lutem bashkëngjitni CV-në tuaj.

Afati për aplikim do të jetë deri më datën **29 janar 2021**. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Aplikimet e pakompletuara dhe të dërguara me vonesë, nuk do të merren parasysh.

Aplikoni këtu: <http://www.monetaks.com/?p=934>